ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E PODUJEVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **615-23-5360-1-3-6**

Sa i përket tenderit për **Furnizim dhe servisim i aparateve për fikjen e zjarrit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

PROGLOBAL SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Dardani, Rr. 28 Nentori, Ll-2, Lok 129
(Adresa)

Prishtinë
(Vendi)

10000
(Kodi postar)

044148645
(Numri Telefonit)

Latif Imeri
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@proglobal-ks.com
(Adresa elektronike)

21.08.2023
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontrate – 25.05.2023
Hapja e ofertave – 06.06.2023
Njoftimi mbi dhënien e kontratës 20.06.2023
Nënshkrimi i kontratës 03.07.2023.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

Hapja e ofertave – 06.06.2023

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

OE Pro Global shpk, per proceduren e prokurimit te larte shenuar, me daten 03.07.2023, ka lidhur Kontrat me autoritetin Kontraktues – Komuna Podujeve, ne nderkohe nga operator ekonomik pjesemarres ne kete procedure te prokurimit eshte kontestuar njoftimi per dhenie te kontrates dhe pas nxjerrjes se vendimit AK – Komuna Podujeveka nxjerr njoftim per anulimin e teresishem te aktivitetit te prokurimit.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit
Neni 28 Specifikimet teknike
Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 70 - Standardet për Sigurimin e Cilësisë
Neni 105 Kompetencat e OSHP-së
Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve.
Neni 113 Shqyrtimi fillestar nga eksperti shqyrtues
Neni 114 Përgjegjësitë e ekspertit shqyrtues dhe të autoritetit kontraktues
- Rregullorja nr. 001/2022, për prokurim publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar,

Operatori Ekonomik "Proglobal"shpk, sipas afatit te parapara me nenin 108/A, te LPP-se, ka parashtruar kërkese per ri shqyrtim te vendimit te AK-se, rrjedhimisht ne kuptim te nenit 109, te LPP-se dhe nenit 63.2, te RRPP-se, nr. 001/2022, paraqesim ketë ankese:

Operatori Ekonomik "Proglobal"shpk, si pale me interes juridiko material sipas nenit 4.2.26, te LPP-se dhe bazuar ne konsistencën dhe vendimmarrjen ne OSHP, përmes shumë vendimeve tjera, e kundërshton njoftimin për anulim te aktivitetit te prokurimit nga ana e AK, ne fazën pas nënshkrimit dhe dhënies se kontratës.

Për procedurën e prokurimit "***Furnizim dhe servisimi i aparateve për fikjen e zjarrit***", me nr prok: ***615-23-5360-1-3-6***, me datën 03.07.2023, Operatori Ekonomik "Proglobal"shpk, ka lidh kontratë me Autoritetin Kontraktues – Komuna Podujeve.

- *PROVE.1 – Kopja e Kontratës se datës 03.07.2023.*

Ne ndërkohe, OE pjesëmarrës me ketë procedurë te prokurimit, me datën 06.07.2023 (pas lidhjes se kontratës) parashtron ankese ne OSHP, ku autorizohet ekspert shqyrtues, dhe pas trajtimit te pretendimeve ankimore, eksperti shqyrtues propozon anulimin e aktivitetit te prokurimit, rrjedhimisht AK dhe OE, pajtohen me raportin, ndërsa paneli shqyrtues me vendimin e datës 07.08.2023, nxjerr vendimin me nr. 472/2023, dhe aprovon pajtimin e arritur ne mes te palëve, rrjedhimisht AK – Komuna Podujeve me datën. 09.08.2023,nxjerr njoftim për anulimin e aktivitetit te prokurimit.

<u>Pretendimet ankimore dhe baza ligjore e procedurës:</u>

Ky proces i prokurimit eshtë karakterizuar me shkelje thelbësore ligjore dhe keqpërdorime, te cilat mund te shkaktoi pasoja financiare dhe pasoja tjera juridike si rezultat i keqpërdorimit te detares zyrtare nga zyrtar te caktuar dhe si rezultat i mos prezantimit te provave materiale te vet aktivitetit te prokurimit.

1. Fillimisht eksperti shqyrtues, sipas raportit te ekspertizës se tije te datës 23.07.2023, përkundër faktit se gjatë shqyrtimit te ankesës nuk e ka prezantuar si prove dhe dëshmi lidhjen e kontratës, draft-kontratë e ngarkuar ne platformën e-prokurim dhe e qasshme, nuk e njofton panelin shqyrtues me faktin se kontrata tani me veç ka qene e lidhur.

2. Ngjashëm AK – Komuna Podujeve, nuk e ka prezantuar faktin se kontrata ka qene e lidhur dhe nuk e ka njoftuar panelin shqyrtues me ketë fakt, rrjedhimisht paneli shqyrtues eshtë lajthitur dhe ka proceduar me vendim ku eshtë miratuar pajtimi i palëve OE ankues dhe Autoritet Kontraktues.

Ne si kompani, përmes kërkesës për ri shqyrtim te datës. 12.08.2023, kemi paraqitur kërkese për ri shqyrtim te AK- Komuna Podujeve, ndërsa AK, ende nuk ka nxjerr vendim kundrejt kërkesës sonë, përkundër obligimit ligjore te dispozitave te nenit 108/A, te LPP-se me datën 16.08.2023, përmes E-mailit AK – Komuna Podujeve, dërgon shkrese dhe potencon se: "*Procedura për te cilën ne jemi ankuar eshtë anuluar me vendim te OSHP-se dhe e njëjta do te ri tenderohet*'.

Këto veprime, paraqesin shkelje ligjore te nenit. 108/A, te LPP-se, paragrafi 6, ku përcaktohet: "*Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë".*

Ne anën tjetër neni 63, paragrafi 2, i RRPP-se, nr. 001/2022, përcakton:

- "*Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligator dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit.* ***Në rastet kur zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk nxjerrë vendim në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, Operatori Ekonomik ka të drejte që të parashtroj një ankese pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit pas skadimit të afatit prej 3 (tre) dite pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim.*** *Në kalkulim të afateve kohore data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim është dita (0)".*

- *PROVE.2 - Kërkesa për ri shqyrtim e datës 16.08.2023 dhe shkresa – Emaili, i AK – Komuna Podujeve dt. 16.08.2023.*

Neni 105, i LPP-se, kompetencat e OSHP-se, paragrafi 2, nënparagrafi 2.6, përcakton: "***nëse kontrata përkatëse nuk është nënshkruar ende ligjërisht nga të dy palët,*** *dhe deri më*

tani të lejuar nga ky ligj, të japin urdhër me të cilën mënjanohet ose pezullohet dhënia e kontratës publike ose rezultati i një konkursi të projektimit".

Pra OSHP, dhe paneli shqyrtues nuk ka qene i njoftuar me lidhjen e kontratës ne mes te palëve, rrjedhimisht eksperti shqyrtues dhe Autoriteti Kontraktues – Komuna Podujeve, kane konsumuar shkelje ligjore dhe nënligjore me rastin e mos raportimit te gjendjes reale. Nenit 16, te rregullores për prokurim publik "Regjistri përmbledhës i Prokurimit" dhe gjenerimin e te dhënave te prokurimit përcaktojnë hapat dhe veprimet qe duhet ti ndërmerr AK.
Për ketë qeshtje ekzistojnë edhe interpretime te KRPP-se, konkretisht, me datën 22.11.2022 eshtë publikuar sqarimi me nr rendor 4, ku përcaktohet:

Pas hyrjes në fuqi të Rregullores për Prokurimin Publik, cilët janë hapat që duhet ndjekur AK

Komisioni i vlerësimit përfundon vlerësimin e ofertave dhe rekomandon Operatorin Ekonomik për dhënie të kontratës.

1. Kërkohen nga OE i rekomanduar për kontratë **dëshmitë për përmbushje të kërkesave të pranueshmërisë** të specifikuara në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.
2. Pas pranimit të dëshmive të pranueshmërisë, Zyrtari përgjegjës i Prokurimit e nënshkruan raportin e vlerësimit dhe raporti ngarkohet në platformën e prokurimit elektronik.
3. Kërkohet nga ZKA dhe ZKF rikonfirmimi i Deklaratës së Nevojave dhe Disponueshmërisë se mjeteve.
4. **Përgatitet Njoftimi mbi Vendimin e autoritetit Kontraktues** (FS:B58) dhe **publikohet** në Sistemin e prokurimit nëpërmjet funksionit "Publikimi i B58".
5. Periudha e pritjes – pritet 5 ditë për kërkesa për rishqyrtim (**dita e publikimit është dita 0 e 5 ditëve të periudhës në pritje).**
6. Nëse nuk ka kërkesa për rishqyrtim, përgatitet dhe publikohet në platformën elektronike **Njoftimi për dhënie te kontratës/Njoftimi për Anulim te aktivitetet te prokurimit**
7. Pas publikimit të Njoftimit për dhënie të kontratës, AK brenda 30 ditëve kalendarike nënshkruan kontratën.
8. Brenda dy dite pas nënshkrimit të kontratës, AK dërgon për publikim FS. **B52 "Njoftim për nënshkrimin e kontratës".**
9. Nëse ka kërkesë për rishqyrtim, parashtrimi i kërkesës për rishqyrtim automatikisht pezullon procedurën e prokurimit dhe në këtë rast ZP njofton të gjitha palët lidhur me pezullimin e procedurës në fjalë, **shqyrton kërkesën, nxjerr vendimin dhe të njëjtin e publikon në sistemin e prokurimit elektronik.**

AK – Komuna Podujeve, te gjitha këto hapa i ka ndjekur nga ne ka kërkuar dëshmitë e përshtatshmërisë, ka publikuar njoftimin për dhënie te kontratës dhe ka lidhur kontratë me ne si OE, prandaj "Pro Global" shpk, kërkon nga paneli shqyrtues, qe te nxjerr ketë:

V E N D I M

TE APROVOHET, ne tërësi ankesa jone si e bazuar
TE ANULOHET, njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit dhe
TE URDHEROHET, AK – Komuna Podujeve qe ta realizoi kontratën e datës 03.07.2023, për ketë procedurë te prokurimit, ne te kundërtën ne si OE, jemi te obliguar qe ketë qeshje ta raportojmë ne organet kompetente mos prezantimin e kontratës se lidhur dhe marrjen e masave ndaj tyre përfshire edhe realizimin e demit dhe fitimit te shkaktuar.

Kompania jone pas nenshkrimit te kontrates me Ak-Komuna e Podujeves, ka bere pregatitjet me te gjitha produktet për realizimin e kësaj procedure te prokurimit te cilat tani pas blerejes, tani i posedon ne stok dhe mos realizimi i kontratës do te shkaktonte dem financiar dhe përgjegjësi tjera te zyrtareve përgjegjës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te konsiderueshme, demet e shkaktuara fitimi i humbur

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*